



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë, më 25.4.2024

Nr. 1147 Prot.

NJOFTIM

Për zhvillimin e seancës publike nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvillon seancë publike si vijon:

Data e seancës 2 maj 2024, ora 11:30.

Çështje për shqyrtim rishitas:

- Projektvendim “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.
- Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Dritan Shaban Bresa”.
- Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Enea Dhimitër Stefa”.
- Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit “Partia Social Demokrate”, z. Nikolin Prend Luli”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

